

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

DHOMA E POSACME E GJYKATËS SUPREME
SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA
SPECIAL CHAMBER OF SUPREME COURT

Data / Datum

16-08-2012

Registrator

Rr. Ilir Konushevi nr. 8, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: ++381 38 500 400, Faks: ++ 381 38 248 076, E-mail: info@pak-ks.org, web: www.pak-ks.org

Likuidimi i NSH KB LIRIA (MIT 007)

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

I mbylljes së procesit dhe planit të riorganizimit të NSH Kooperativa
Bujqësore "LIRIA"

Njësia e Likuidimeve nga AKP & Zyra Rajonale e Mitrovicës
Versioni në Gjuhën Shqipe

Gusht 2012

NSH KB LIRIA MIT 007 (Fi 506/92) në Likuidim

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU	
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO	
N.S.H, D.P, S.O.E AC LIRIA	
Në Likuidim / U Likvidaciju / In Liquidation	
Nr. 0006/12	OUT
Br. 42	Data : 15/08/2012
No. Pg. 42	Date : 15/08/2012
ZR/RK/RO - Mitrovicë / Mitrovica	



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

DHOMËS SË POSAÇME

TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

Datë : Gusht 2012

Nr. rastit: Të caktohet

Gjykatësi: Të emërohet

Aplikuesi: Autoriteti i Likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore KB "LIRIA" Skenderaj (në Likuidim),

RAPORTI PËRFUNDIMTAR i Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore Kooperativa Bujqësore "LIRIA" Skenderaj (në Likuidim) dhe KËRKESA për mbylljen e rastit të likuidimit

PËRMBLEDHJE E KËRKESËS

Autoriteti i Likuidimit (tani e tutje "AL") i Ndërmarrjes Shoqërore Kooperativa Bujqësore (tani e tutje "Ndërmarrja") "LIRIA" (në Likuidim) nga Skenderaj, e paraqet Raportin Përfundimtar të AL për këtë Ndërmarrje me kërkesë (tani e tutje Kërkesa"), që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (tani e tutje "Dhoma e Posaçme") të aprovoj raportin përfundimtar dhe të lëshoj vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit.

AL e paraqet këtë Kërkesë në pajtim me nenin 43 dhe 44 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (tani e tutje "Shtojca e Ligjit të AKP-se).

AL i NSH KB "LIRIA" nga Skenderaj (në Likuidim) i propozon Dhomës së Posaçme që pas shqyrtimit të Kërkesës të aprovoj Raportin Përfundimtar si dhe të bie Vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit ndaj kësaj Ndërmarrjeje.

Për dhe në emër të Autoritetit të Likuidimit
të Ndërmarrjes Shoqërore KB "LIRIA" Skenderaj (në Likuidim)
Adrian Kelmendi, Kryesues i Autoritetit të Likuidimit



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT TË NSH KB "LIRIA" SKENDERAJ (në Likuidim)

Raporti Përfundimtar i AL për NSH KB "LIRIA" nga Skenderaj përmban:

1. Përmbledhjen Ekzekutive
2. Historiku i shkurtër dhe statusi i NSH KB "LIRIA" nga Skenderaj (në Likuidim)
3. Historiku i Procesit të Likuidimit
4. Vendimet mbi themelimin e Komisionit të Likuidimit dhe Autoritetit të Likuidimit
5. Publikimet e njoftimeve për fillimin e likuidimit në gazeta
6. Njoftimet formale Gjykatave dhe Institucioneve relevante mbi fillimin e procesit të likuidimit
7. Asetet e mbetura
8. Shkresë konfirmuese nga Dhoma e Posaçme
9. Pasqyra Përfundimtare Financiare
10. Raporti i parave të imëta
11. Letër konfirmimi nga Administrata tatimore e Kosovës
12. Letër konfirmimi nga Kuvendi Komunal lidhur me tatimin në Pronë

Shtojca 1

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

NDËRMARRJA SHOQËRORE KB“LIRIA”

Emërtimet e mëparshme dhe i tanishëm i ndërmarrjes:

OPB, "Produkt" Organizate Themelore e Kooperantve "Qirez", Qirez Fi-226/78

Kooperativa Bujqësore "Qirez" Fi-1598/90

Kooperativa Bujqësore "Qirez" – Skenderaj, Fi -506/92

Nga viti 2000: KB Liria - është regjistruar me numër provisional no. UNMIK – 80288298

Aktiviteti: Shërbime Bujqësore

Komuna: Skenderaj, Regjioni i Mitrovicës

Me vendimin e Bordit të Drejtoreve të Agjencisë të datës 28.05.2010, ka filluar procedura e likuidimit ndaj Ndërmarrjes Shoqërore KB "LIRIA" nga Skenderaj. Më 04 Gusht 2010, është bërë themelimi i Komisionit të Likuidimit për NSH KB"LIRIA", sipas autoritetit të dhënë me vendimin e lartcekur të Bordit të Drejtoreve të AKP-së.

Me datën 29 Mars 2012, Bordi i Drejtoreve i AKP-së, bazuar në nenin 9 të Ligjit të AKP-së, dhe nenit 6,12 dhe 13 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka miratuar Vendimin për themelimin e Autoritetit të Likuidimit. Në të njëjtën kohë është bërë edhe emërimi i anëtarëve nga stafi i AKP-së për të shërbyer në kuadër të Autoritetit të tanishëm të Likuidimit. Vendimet mbi emërimin e Komisionin paraprak të Likuidimit si dhe Autoritetin e Likuidimit janë paraqitur në Shtojcën 4 të Raportit Përfundimtarë.

Një histori e shkurtër e kronologjisë së procesit të likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore KB"LIRIA" (në Likuidim) është paraqitur në Shtojcën 3 të Raportit Përfundimtarë. Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-67 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nenit 39 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 mbi Organizatat Tregtare si dhe nenit 43.3 (d), (e) dhe nenit 49 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve, Komisioni i Likuidimit në muajin Gusht 2010, ka lëshuar njoftimet e nevojshme për fillimin e procesit të likuidimit në gazetën Koha Ditore, Kosova Sot, dhe Blic me tirazh të konsiderueshëm në Kosovë, dhe në Serbi. Kopjet e njoftimeve janë të paraqitura në Shtojcën 5 të Raportin Përfundimtarë.

Ndërsa njoftimet formale të gjykatave kompetente të vendit, institucioneve relevante për fillimin e procedurës së likuidimit përfshirë fletëkthimet si dëshmi për pranimin e njoftimeve nga ana e këtyre institucioneve, si dhe njoftimet e kreditorëve të njohur dhe potencial, janë të përmbledhura në Shtojcën 6.

Komisioni i likuidimit paraprake si dhe AL ka konstatuar se nuk ka asete të kësaj NSH-ja për tu shitur. Për këtë qëllim AL posedon konfirmimin nga Agjencia Kadastrale e Kosovës e paraqitur si Shtojca 7. Gjatë afatit ligjor për paraqitjen e kërkesave kreditore, nuk është parashtruar asnjë kërkesë në afat kundër NSH KB"LIRIA". AL i ka bashkangjitur Raportit Përfundimtarë shkresën nga Dhoma e Posaçme e paraqitur si Shtojca 8, me të cilën konfirmohet se pranë Dhomës së Posaçme nuk është parashtruar asnjë padi kundër NSH në fjalë dhe rrjedhimisht nuk ka pasur vendime të marrura nga Autoriteti i Likuidimit.

Të hyrat nga privatizimi dhe shitja e aseteve përmes likuidimit janë zero euro (0 €), për faktin se ndërmarrja nuk ka asete të realizueshme, ndërsa shpenzimet e likuidimit (pa përfshirë shpenzimet gjyqësore) kanë arritur në vlerë prej 2,202.90 €, që përfshijnë shpenzimet e njoftimeve për fillimin e likuidimit dhe


shpenzimet operative. Llogaria e Fondeve të Likuidimit dhe Pasqyra e Llogarisë së Likuidimit janë të përfshira në Shtojcën 9 dhe 10 të këtij raporti.

AL gjithashtu ka marrë konfirmimet nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Komuna përkatëse se nuk ka obligime tatimore dhe si dhe nuk ka obligime të tatimit në pronë, konfirmime këto të bashkangjitura në Shtojcën 11 dhe në Shtojcën 12 të Raportit Përfundimtarë.

Në mbledhjen e mbajtur të Bordit të Drejtorëve të AKP-së me datë 20 Korrik 2012, Bordi i Drejtoreve është informuar me përmbajtjen e Raportit Përfundimtar të AL për NSH KB "LIRIA" Skenderaj.


Për dhe në emër të Autoritetit të Likuidimit
të Ndërmarrjes Shoqërore KB "LIRIA" Skenderaj (në Likuidim)

Adrian Kelmendi




Kryesues i Njesisë për Likuidime nga AKP - AKP Prishtinë,
Kryesues i Autoritetit të Likuidimit

Elza Shukriu



Zyrtare për Likuidim - AKP ZR Mitrovicë,
Anëtare dhe Zyrtare e lëndës

Dejan Popovic



Zyrtar për Privatizim - AKP ZR Mitrovicë,
Anëtar (përfaqësues i komunitetit pakicë)

Shtojca 2

**HISTORIKU I SHKURTËR DHE STATUSI I NSH KB“LIRIA”,
SKENDERAJ**

HISTORIKU I SHKURTËR DHE STATUSI I NSH KB “LIRIA”, Skenderaj (në Likuidim)

Organizata Themelore e Punës së Bashkuar (OTHPB) “Çirez” në Skenderaj, ishte pjesë përbërëse e Organizatës të Punës së Bashkuar “Produkti” në Skenderaj. OPB “Produkti”, paraprakisht qeverisej nën tipin (llojin) e pronësisë shoqërore dhe ishte pjesë e përbërëse e kombinatit agro-industrial “Agrokosova”, në pronësi shoqërore.

Punëtorët e OTHK “Çirez”, në bazë të referendumit të mbajtur me datën 19.02.1990, vendosin për ndarjen e kësaj OTHK-je nga OPB “Produkti” dhe si rrjedhojë kjo OTHK shëndrohet në Kooperativën Bujqësore “Çirez”. Sipas regjistrimit në Gjykatën Ekonomike Fi 1598/90 ky entitet ishte një Kooperativë Bujqësore. Njëkohësisht edhe sipas regjistrimit në Gjykatën Ekonomike Fi 506/92 ky entitet ishte një Kooperativë Bujqësore.

Nga dokumentacioni përkatës, nuk është gjetur ndonjë provë se KB “Çirez”, ka pasur ndonjë formë të transformimit pronësor – juridik. Në këtë entitet nuk kanë qenë të vendosura masat e dhunshme administrative. Në arkivin e AL dhe në zyrën për regjistrimin e kërkesave pranë Agjencisë nuk është evidentuar ndonjë kërkesë apo padi të karakterit pronësor me të cilën do të kontestohet statusi i kësaj Ndërmarrjeje.

Në anën tjetër, me datën 30.08.2000, është bërë regjistrimi i përkohshëm i këtij subjekti juridik në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së, me numër biznesi 80288298 me emërtimin Kooperativa Bujqësore (KB) “LIRIA”, me status të personit juridik – Kooperativë Bujqësore.

Rrjedhimisht, Agjencia përmes procedurave standarde për verifikimin e statusit të Ndërmarrjeve shoqërore të cilat bien në autorizimet administrative të Agjencisë, pas shqyrtimit të dokumentacionit relevante statusor me datë 02.06. 2009, ka determinuar statusin e këtij personi juridik si Ndërmarrje Shoqërore e cila bie në mandatin dhe autorizimet e Agjencisë sipas nenit 5.1 të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Shtojca 3

HISTORIKU I SHKURTËR I PROCESIT TË LIKUIDIMIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR MBYLLJEN E PROCESIT DHE PLANIT TË RIORGANIZIMIT PËR KB LIRIA

NDËRMARRJA SHOQËRORE KB "LIRIA"

Komuna:	Skenderaj, Regjioni i Mitrovicës
Data e fillimit të Likuidimit:	04 Gusht 2010
Data e afatit të fundit për dorëzimin e kërkesave:	16 Tetor 2010
Aktiviteti:	Shërbime Bujqësore

HISTORIKU I SHKURTËR I PROCESIT TË LIKUIDIMIT

3.1. Emërimet në Komisionin dhe Autoritetin e Likuidimit

3.1.1. Në pajtim me nenin 9 të Ligjit mbi AKP-në (Nr. 03/L-067), Nenin 3 dhe 13.3 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2007/1, dhe Nenin 6.3 të Politikave Operacionale të AKP-së (vitit 2008), me datë 04 Gusht 2010, në pajtim me vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 28 Maj 2010, është bërë emërimi i Anëtarëve të parë të Komisionit të Likuidimit për NSH KB "LIRIA" (në Likuidim). Vendimi mbi emërimet është i bashkëlidhur Raportit përfundimtar në Shtojcën 4.

Personat e emëruar si anëtare të Komisionit të Likuidimit nga Agjencia me datë 04.08.2010 janë :

Nurten Deva	Udhëheqëse e Ekipit për Qeverisjen Korporative-AKP ZR Mitrovicë, Kryesuese
Elza Shukriu	Zyrtare për Zhvillim të Ndërmarrjeve-AKP ZR Mitrovicë, Anëtare dhe Zyrtare e lëndës
Dejan Popovic	Zyrtar për Zhvillim të Ndërmarrjeve-AKP ZR Mitrovicë, Anëtar dhe Sekretar
Xhevat Veseli	Zyrtar Ligjor-AKP ZR Mitrovicë, Anëtar

Paraprakisht me vendimin e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar ("PCN") të datës 05.07.2010, si anëtar i emëruar në Komisionin e Likuidimit nga PCN është emëruar Marian Nieora. Poashtu me vendimin e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar Madalin Olariu është emëruar si zëvendës (i përkohshëm) i anëtarit të emëruar nga PCN. AL nuk posedon dëshmi me shkrim se personat e lartpërmendur kanë dhënë dorëheqje zyrtare.

3.1.2. Me datën 29 Mars 2012, Bordi i Drejtorëve i AKP-së, duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit të AKP-së, dhe nenit 6,12 dhe 13 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka miratuar Vendimin për themelimin e Autoritetit të Likuidimit dhe janë emëruar anëtarët vijues për të shërbyer në kuadër të këtij Autoriteti të Likuidimit. Vendimi mbi emërimet është i bashkëlidhur Raportit përfundimtar në Shtojcën 4.

Adrian Kelmendi	Kryesues i Njesisë për Likuidime të NSH-ve-AKP Prishtinë, Kryesues
Elza Shukriu	Zyrtare për Likuidim-AKP ZR Mitrovicë, Anëtare dhe Zyrtare e lëndës
Dejan Popovic	Zyrtarë për Privatizim-AKP ZR Mitrovicë, Anëtar (përfaqësues i komunitetit pakicë)

3.1.3. Anëtarët e lartpërmendur të Komisionit dhe të AL kanë nënshkruar Deklaratat për Konflikt Interesi si në vijim:

Komisioni i Likuidimit:

Nurten Deva	e emëruar më 04/08/2010	nënshkruar më 10/08/2010
Elza Shukriu	i emëruar më 04/08/2010	nënshkruar më 10/08/2010
Xhevat Veseli	i emëruar më 04/08/2010	nënshkruar më 10/08/2010
Dejan Popovic	i emëruar më 04/08/2010	nënshkruar më 10/08/2010
Marian Nieora	i emëruar më 05/07/2010	nënshkruar më 10/08/2010
Madalin Olariu	i emëruar – AL.më 05/07/2010	nënshkruar më 10/08/2010

Autoriteti i Likuidimit:

Adrian Kelmendi	i emëruar më 29/03/2012	nënshkruar më 17/04/2012
Elza Shukriu	i emëruar më 29/03/2012	nënshkruar më 26/04/2012
Dejan Popovic	e emëruar më 29/03/2012	nënshkruar më 26/04/2012

3.1.4. Mbledhjet e Komisionit të Likuidimit

3.1.4.1. Mbledhja e mbajtur me datën 04.08.2010

Procesverballi: I nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Likuidimit

Të Pranishëm: Nurten Deva–Kryesuese; Dejan Popovic (Sekretar)–anëtar, Xhevat Veseli (Zyrtar Ligjor)–anëtar, Marian Nieora (EPCN)–anëtar;

Mysafirë: Gentian Gurra (Pohl Consulting), Gazmend Pallaska (Pohl Consulting);

Munguan: Elza Shukriu (Zyrtare e Lëndës)–anëtare

Pikat Kryesore: Vërtetimi i emërimeve të Anëtarëve; Emërimi i Sekretarit; Vërtetimi se të anëtarët e kanë nënshkruar konfliktin e interesit, Njoftimi nga zyrtari i lëndës se KB Liria nuk ka asete nuk ka shitje përmes privatizimit as likuidimit dhe nuk ka fonde në dispozicion, nuk ka kërkesa, anëtarët pajtohen të dërgojnë njoftimet për KEK-un, Kompaninë e Ujësjellësit, Kompaninë e Pastrimit, PTK-së, Komunës dhe ATK-së, Gjykatave, anëtarët pajtohen të kërkojnë 200 € para të imta, zyrtarja e lëndës njofton se ndërmarrja nuk ka punëtor dhe nuk ka asete.

3.1.4.2. Mbledhja e mbajtur me datën 28.08.2010

Procesverballi: I nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Likuidimit

Të Pranishëm: Të Pranishëm: Nurten Deva–Kryesuese; Elza Shukriu (Zyrtare e Lëndës)–anëtare, Dejan Popovic (Sekretar)–anëtar, Xhevat Veseli (Zyrtar Ligjor)–anëtar, Marian Nieora (EPCN)–anëtar;

Mysafirë: Gentian Gurra (Pohl Consulting), Gazmend Pallaska (Pohl Consulting);

Pikat Kryesore: Miratimi i Procesverbalit paraprak; diskutimi dhe vlerësimi i detyrave dhe çështjeve; njoftimi për Regjistrin e Bizneseve është dërguar, njoftimet e para e të dyta në gazeta janë shpallur, njoftimet për gjykata dhe banka do të bëhen, në regjistrin e kërkesave nuk ka të regjistruara asnjë kërkesë, ndërmarrja nuk ka vula, nuk ka asete.

3.1.4.3. Mbledhja e mbajtur me datën 23.11.2010

Procesverbali: I nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Likuidimit

Të Pranishëm: Nurten Deva–Kryesuese; Elza Shukriu (Zyrtare e Lëndës)–anëtare, Dejan Popovic (Sekretar)–anëtar, Xhevat Veseli (Zyrtar Ligjor)–anëtar, Marian Nieora (EPCN)-anëtar;;
Munguan: Gentian Gurra (Pohl Consulting);
Mysafirë: Gazmend Pallaska (Pohl Consulting);
Pikat Kryesore: Njoftimi se është formuar Dosja e likuidimit, afati për dërgimin e kërkesave ka kaluar me 16 Tetor 2010, zyrtari i lëndës informon se njoftimi për gjykatat lokale është bërë si dhe për banka.

3.1.4.4. Mbledhja e mbajtur me datën 24.01.2011

Procesverbali: I nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Likuidimit

Të Pranishëm: Nurten Deva–Kryesuese; Elza Shukriu (Zyrtare e Lëndës)–anëtare, Dejan Popovic (Sekretar)–anëtar, Xhevat Veseli (Zyrtar Ligjor)–anëtar, Marian Nieora (EPCN)-anëtar;
Munguan: Gentian Gurra (Pohl Consulting);
Mysafirë: Gazmend Pallaska (Pohl Consulting);
Pikat Kryesore: Lidhur me çështjet kadastrale nga zyrtari i lëndës kërkohet të dërgoi shkresa Zyrës Kadastrale në Skenderaj dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës për informata nëse ndërmarrja ka ndonjë aset të regjistruar. Lidhur me çështjen e kërkesave, obligohet kryesuesi i komisionit të kërkoj konfirmim nga Njësia e Kërkesave që nuk ka kërkesa lidhje me këtë ndërmarrje. Nga Kryesuesi i Komisionit kërkohet të siguron nga Departamenti i Financave raportin lidhje me shpenzime të bëra nga Zyra Qendrore e në lidhje me NSH Liria.

4. Asetet e mbetura në fillim të Likuidimit të Ndërmarrjes

Kooperativa Bujqësore “LIRIA” nuk ka asete në fillim të Likuidimit.

5. Njoftimet e lëshuara nga Komisioni i Likuidimit

Në përputhje me Nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-67 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Nenit 39 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 mbi Organizatat Tregtare si dhe Nenit 43.3 (d), (e) dhe Neni 49 i Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve, Komisioni i Likuidimit ka lëshuar Njoftimet vijuese:

5.1 Njoftimet për Fillimin e Likuidimit në gazeta:

09 Gusht 2010, Njoftimi i parë në gj. Shqipe dhe gj. Angleze	në KOHA DITORE
09 Gusht 2010, Njoftimi i parë në gj. Shqipe dhe gj. Angleze	në KOSOVA SOT
09 Gusht 2010, Njoftimi i parë në gj. Serbe dhe gj. Angleze	në Blic
16 Gusht 2010, Njoftimi i dytë në gj. Shqipe dhe gj. Angleze	në KOHA DITORE
16 Gusht 2010, Njoftimi i dytë në gj. Shqipe dhe gj. Angleze	në KOSOVA SOT
16 Gusht 2010, Njoftimi i dytë në gj. Serbe dhe gj. Angleze	në Blic

Kopjet e njoftimeve të shpallura në gazetatat e lartpërmendura janë të bashkëlidhura këtij raporti si Shtojca 6.

5.2. Njoftimi Zyrës për Regjistrimin e Bizneseve:

Më 09 Gusht 2010, (në tri gjuhët), ndërsa sipas flet-kthimit të PTK-së, njoftimi është pranuar më 13 Gusht 2010. Kopja e njoftimit me flete-kthimin nga PTK i është bashkëlidhur raporti si Shtojca 6.

5.3. Njoftimet Kreditorëve të Njohur dhe Potencial, që përfshinë:

Kuvendi Komunal i Skenderajt, Sektori për Tatim mbi Pronë,	më 26 Gusht 2010
Administrata Tatimore e Kosovës, Zyra Regjionale e Mitrovicës,	më 27 Gusht 2010
Ujësjiellësi Regjional,	më 27 Gusht 2010
Kompania Regjionale e Mbeturinave,	më 27 Gusht 2010
Post-Telekomi i Kosovës,	më 27 Gusht 2010
Korporata Energjetike e Kosovës,	më 27 Gusht 2010

5.4. Njoftimi Gjykatave.

Kopjet e fletë-kthimeve të PTK-së tregojnë që Gjykatave vijuese i janë dërguar Njoftimet:

Gjykata Komunale e Skenderajt	më 02 Shtator 2010
Gjykata Komunale e Vushtrrisë	më 02 Shtator 2010
Gjykata Komunale e Mitrovicës	më 02 Shtator 2010
Gjykata Komunale në Leposaviq	më 30 Gusht 2010
Gjykata Komunale në Zvečan	më 30 Gusht 2010
Gjykata Komunale në Zubin Potok	më 02 Shtator 2010
Gjykata e Qarkut të Mitrovicës	më 02 Shtator 2010
Gjykata Ekonomike Prishtinës	më 02 Shtator 2010
Gjykata Supreme e Kosovës	më 02 Shtator 2010
Dhoma e Veçantë e Gjykatave Supreme e Kosovës	më 02 Shtator 2010

Kopja e njoftimit me flete-kthimin nga PTK i është bashkëlidhur raporti si Shtojca 6.

6. Pasqyra e Kërkesave

Nuk ka kërkesa të regjistruara.

Shtojca 4

**VENDIMET MBI THEMELIMIN E KOMISIONIT TË LIKUIDIMIT
DHE AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi Nr. 8, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: ++ 381 38 500 400. Fax: ++ 381 38 248 076, E-mail: info@pak-ks, web: www.pak-ks.org

NJOFTIM

Për

Fillimin e Likuidimit

&

Caktimin e anëtarëve të parë të Komisionit të Likuidimit

Emri i Ndërmarrjes: Kooperativa Bujqësore "Liria"

Emrat alternativ: OPB "Produkt" Organizata Themelore e Kooperativave "Qirez" në Qirez Fi-226/78; PRO "Produkt" Osnovna Organizacija Kooperativa "Çirezi", Çirez Koperativa Bujqësore "Qirez" – Skënderaj, Fi-506/92; Zemljoradnicka zadruga "Çirez" – Srbica, Fi-506/92

Në bazë të nenit 9.1 të Ligjit 03/L-067 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, dhe në bazë të vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 28 Maj 2010, Likuidimi i Ndërmarrjes së cekur më lart fillon që nga data e këtij Njoftimi.

Sipas autorizimit që i është dhënë Zëvendës Drejtorëve Menaxhues të AKP-së, me vendimin e datës 28 Maj 2010, në përputhje me nenin 9.2 të Ligjit 03/L-067 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, personat në vijim janë emëruar si anëtarë të parë të Komisionit të Likuidimit dhe është efektive nga data e këtij Njoftimi:

Nurten Deva – UL – Kryetare

Elza Shukriu – ZZHN – Anëtar (dhe/ose Zyrtare e lëndës)

Dejan Popovic – ZZHN – Anëtar (dhe/ose Sekretar)

Xhevat Veseli – ZZHN Ligjor – Anëtar

.....
Mrika Tahiri

Zëvendës Drejtor Menaxhues

Realizimi i Aseteve

Agjencia Kosovare e Privatizimit

.....
Naim Avdiu

Zëvendës Drejtor Menaxhues

Qeverisja Korporative

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Data: 04 August 2010

Njoftimi për fillimin e likuidimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Numri i referencës:

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit të AKP-së, dhe nenit 6, 12 dhe 13 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit ("Ligji i AKP-së"), si dhe duke u bazuar në pikën 7.3.2 të Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit Agjencisë ("Agjencia") më 29/03/2012, nxjerrë:

V E N D I M

Për Themelimin e Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore ("NSH") Kooperativa Bujqësore "LIRIA" nga Komuna e Skenderajt

1. Themelohet Autoriteti i Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore Kooperativa Bujqësore "LIRIA", Komuna e Skenderajt, në përbërje prej:

- Adrian Kelmendi, Kryesues i Autoritetit të Likuidimit
- Elza Shukriu, Anëtar i Autoritetit të Likuidimit - Oficer i Rastit", dhe
- Dejan Popovic, Anëtar i Autoritetit të Likuidimit (përfaqësues i komunitetit pakicë).

2. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë me datën 28.05.2010, ka iniciuar procedurën e likuidimit, dhe ka themeluar Komisionin e Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore "Kooperativa Bujqësore – "LIRIA" nga Skenderaj në përputhje me ligjet e aplikueshme.

3. Ndërmarrja Shoqërore "Kooperativa Bujqësore – "LIRIA" nga Skenderaj, është e regjistruar pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me numër Fi 506/92 të datës 05.03.1992. Statusi ligjor i kësaj ndërmarrjeje është shqyrtuar nga Agjencia në përputhje me nenin 5 të Ligjit të AKP-së si dhe Politikave Operacionale të Agjencisë.

4. Ndërmarrja Shoqërore "Kooperativa Bujqësore – "LIRIA", është e njohur edhe me emrat të tjerë alternativë si:

- OPB "Produkt" OTHK "Qirez" Fi-226/78
- KB "Qirez" / ZZ "Cirez" Fi-506/92

5. Anëtarët e Autoritetit të Likuidimit, emërohen në këto pozita deri në vendimin e ardhshëm, përkatësisht deri me datën e shuarjes së Autoritetit të Likuidimit. Pushimi eventuale i marrëdhënies së punës së cilitdo nga të emëruarit në këtë autoritet apo mos vazhdimi eventuale i kontratës së punës ndaj cilitdo prej tyre, nga ana e Agjencisë, ka efekt të drejtpërdrejtë edhe në pushimin e funksionit të tyre në këtë autoritet.

6. Anëtarët e Autoritetit të Likuidimit punojnë në pajtim me rregullativën e aplikueshme ligjore.

7. Në rastet eventuale të konfliktit të interesit, ku mund të vihet në dyshim objektiviteti, Kryesuesi apo cilitdo nga anëtarët e Autoritetit të Likuidimit duhet të kërkojnë, lirin nga pjesëmarrja në atë proces të likuidimit.

8. Kryesuesi dhe anëtarët e Autoritetit të Likuidimit janë përgjegjës që të ruajnë fshehtësinë e informacioneve të fituara gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.
9. Me këtë vendim për themelimin e Autoritetit të Likuidimit pushon funksionimi i Komisionit të Likuidimit. Komisioni paraprak është i obliguar që të bëjë pranim-dorëzimin e rregullt të kompetencave tek Autoriteti i Likuidimit.
10. Ky vendim hyn në fuqi një ditë pas nënshkrimit të tij.

Shkëlzen Lluka



Drejtör Menaxhues
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Prishtinë, më 05 / 04 / 2012

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të autoritetit të likuidimit
- Menaxhmentit të Agjencisë dhe
- Arkivit të AKP-së.

Shtojca 5

PUBLIKIMET E NJOFTIMEVE PËR LIKUIDIM NË GAZETA

NSH KB LIRIA MIT 007 (Fi 506/92) në Likuidim

Koha Ditore

e hënë • 9 gusht 2010

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM PËR LIKUIDIM

NSH Kooperativa Bujqësore Liria - Fi-506/92, Komuna e Skenderajt, Regjioni i Mitrovicës

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:
OPB "Produkt" OTHK "Qirez" Fi-226/78; KB "Qirez" / ZZ "Qirez" Fi-506/92

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-067 Mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 39.3 dhe 39.6 të Rregullores së UNMIK-it 2001/6 mbi Organizatat Tregtare, dhe Neni 43.3 (d) dhe (e) dhe Neni 49 të Rregullores së UNMIK-it 2005/48 mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Pavarisë së tyre, **JEPET NJOFTIMI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar prej **04 gusht 2010**, në bazë të vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me 28 maj 2010 sipas Nenit 9.1 të Ligjit Nr. 03/L-067.

Në përputhje me nenin 43.3 (d) dhe (e) të Rregullores së UNMIK-it 2005/48, çdo person i cili beson se ai/ajo ka të drejtë kërkesë ndaj kësaj Ndërmarrjeje - qoftë si kreditor apo në lidhje me çfarëdo lloj aseti që ka të bëjë me Ndërmarrjen, apo si pronar i Ndërmarrjes, si dhe çfarëdo kërkesë tjetër - duhet të paraqet Deklarimin e Kërkesës për Likuidim deri më ose para 16 tetor 2010. Nëse nuk bëhet kjo, mund të rezultojë që personat e tillë nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në ndarjen e fondeve të krijuara nga likuidimi.

Njoftim i rëndësishëm: Pa kurrfarë paragjyqimi për çfarëdo kërkesë në të ardhmen, Komiteti i Likuidimit njofton të gjithë të interesuarit që sipas njohurive që ka, NSH KB Liria nuk posedon kurrfarë prona të regjistruar në inventarin e saj, prandaj nuk do të ketë kurrfarë fondeve në dispozicion për shpërndarje.

Dëshmia e Kërkesës për Likuidim mund të merret dhe duhet të dorëzohet në zyrën e AKP-së si më poshtë:
Agjencia Kosovare e Privatizimit
 Zyra Rajonale në Mitrovicë, Mbretëresha Teutë p.n. (përballë Palestrës së Sporteve)
 Tel: +381 (28) 534 690 Fax: +381 28-534 590

Formularët për kërkesa gjithashtu mund të merren edhe nga faja e internetit e AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Për detaje se si të dorëzohet kërkesa, shih "Si të paraqitni një kërkesë".

Lista e aseteve dhe lista e paraqitësve të kërkesave do të mbahet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në Zyrën Rajonale në Mitrovicë, Mbretëresha Teutë p.n. (përballë Palestrës së Sporteve) dhe do të jetë e hapur për shqyrtim publik në këtë zyre pas 16 tetor 2010 (ose ndonjë datë tjetër që mund të shpallët publikisht) deri në ngjyrimin e ardhshëm. Nëse keni arsye të pranueshme për pamundësi të udhëtimit deri në vendin e lartpërmendur, ju lutemi të kontaktoni në adresën e mëposhtme për të arrituruar mënyra tjera të qajjes.

Aseti do të ofrohet për shpërndarje nëpërmjet tenderit me ofertë të mbyllur në datën (jo më heret se 1 nëntor) që do të publikohet, duke përfshirë edhe në faqen e internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (www.pak-ks.org).

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NOTICE OF LIQUIDATION

of
SOE Agricultural Cooperative Liria, Fi-506/92, Skenderaj/Srbica Municipality, Mitrovica/a Region

Alternative/Former names and registration numbers:
OPB "Produkt" OTHK "Qirez" Fi-226/78; KB "Qirez" / ZZ "Qirez" Fi-506/92

Pursuant to Article 9 of Law No. 03/L-067 on The Privatisation Agency of Kosovo, Sections 39.3 and 39.6 of UNMIK Regulation 2001/6 on Business Organisations, and Sections 43.3(d) and (e) and Section 49 of UNMIK Regulation 2005/48 on the Reorganisation and Liquidation of Enterprises and their Assets, **NOTICE IS HEREBY GIVEN** that the Liquidation of the above enterprise was commenced with effect from **04 August 2010** pursuant to a decision of the Board of the Privatisation Agency of Kosovo dated **28 May 2010** under Article 9.1 of Law No. 03/L-067.

In accordance with Sections 43.3 (d) and (e) of UNMIK Regulation 2005/48, any person who believes he/she has a claim against the Enterprise - either as creditor or in respect of any assets related to it or as an owner of the Enterprise or any other claim - should file a **Liquidation Proof of Claim** on or before **16 October 2010**. Failure to do so may result in such persons being unable to participate in any proceeds of sale of liquidation.

Important Notice: With no prejudice to any future claims, the Liquidation Committee advises all concerned that to its best knowledge there are no assets in the inventory of SOE AC Liria, and therefore there will be no funds available for distribution.

The Liquidation Proof of Claim forms can be obtained from, and must be filed with, the following office of the Privatisation Agency of Kosovo:
 Privatisation Agency of Kosovo
 Mitrovica Regional Office
 Address: Mbretëresha Teutë nn, Mitrovica/a (opposite to the Sports Centre)
 Tel: +38128-534-690; Fax: +38128-534-590

The claim forms may also be obtained from the PAK web site at www.pak-ks.org. For details on how to file a claim see "How to register a claim."

A list of assets and a list of claimants will be maintained at the Privatisation Agency of Kosovo, Mitrovica Regional Office, address: Mbretëresha Teutë nn, Mitrovica/a (opposite to the Sports Centre) and will be available for public inspection at this office after 16 October 2010 (or such later date as may publicly be announced) until further notice. If you have legitimate reasons as to why you are unable to travel to the above address, please contact the address to make other access arrangements.

The assets will be offered for sale by sealed bid tender at a date (no earlier than 1 November 2010) to be advertised, including on the Privatisation Agency of Kosovo web site (www.pak-ks.org).

Kosova Sot

28 KOSOVA SOT

Marketing

e hënë, 9 gusht 2010

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM PËR LIKUIDIM

NSH Kooperativa Bujqësore Liria - Fi-506/92, Komuna e Skenderajt, Regjioni i Mitrovicës

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:
OPB "Produkt" OTHK "Qirez" Fi-226/78; KB "Qirez" / ZZ "Qirez" Fi-506/92

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-067 Mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 39.3 dhe 39.6 të Rregullores së UNMIK-it 2001/6 mbi Organizatat Tregtare, dhe Neni 43.3 (d) dhe (e) dhe Neni 49 të Rregullores së UNMIK-it 2005/48 mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Pavarisë së tyre, **JEPET NJOFTIMI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar prej **04 gusht 2010**, në bazë të vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me 28 maj 2010 sipas Nenit 9.1 të Ligjit Nr. 03/L-067.

Në përputhje me nenin 43.3 (d) dhe (e) të Rregullores së UNMIK-it 2005/48, çdo person i cili beson se ai/ajo ka të drejtë kërkesë ndaj kësaj Ndërmarrjeje - qoftë si kreditor apo në lidhje me çfarëdo lloj aseti që ka të bëjë me Ndërmarrjen, apo si pronar i Ndërmarrjes, si dhe çfarëdo kërkesë tjetër - duhet të paraqet Deklarimin e Kërkesës për Likuidim deri më ose para 16 tetor 2010. Nëse nuk bëhet kjo, mund të rezultojë që personat e tillë nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në ndarjen e fondeve të krijuara nga likuidimi.

Njoftim i rëndësishëm: Pa kurrfarë paragjyqimi për çfarëdo kërkesë në të ardhmen, Komiteti i Likuidimit njofton të gjithë të interesuarit që sipas njohurive që ka, NSH KB Liria nuk posedon kurrfarë prona të regjistruar në inventarin e saj, prandaj nuk do të ketë kurrfarë fondeve në dispozicion për shpërndarje.

Dëshmia e Kërkesës për Likuidim mund të merret dhe duhet të dorëzohet në zyrën e AKP-së si më poshtë:
Agjencia Kosovare e Privatizimit
 Zyra Rajonale në Mitrovicë, Mbretëresha Teutë p.n. (përballë Palestrës së Sporteve)
 Tel: +381 (28) 534 690 Fax: +381 28-534 590

Formularët për kërkesa gjithashtu mund të merren edhe nga faja e internetit e AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Për detaje se si të dorëzohet kërkesa, shih "Si të paraqitni një kërkesë".

Lista e aseteve dhe lista e paraqitësve të kërkesave do të mbahet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në Zyrën Rajonale në Mitrovicë, Mbretëresha Teutë p.n. (përballë Palestrës së Sporteve) dhe do të jetë e hapur për shqyrtim publik në këtë zyre pas 16 tetor 2010 (ose ndonjë datë tjetër që mund të shpallët publikisht) deri në ngjyrimin e ardhshëm. Nëse keni arsye të pranueshme për pamundësi të udhëtimit deri në vendin e lartpërmendur, ju lutemi të kontaktoni në adresën e mëposhtme për të arrituruar mënyra tjera të qajjes.

Aseti do të ofrohet për shpërndarje nëpërmjet tenderit me ofertë të mbyllur në datën (jo më heret se 1 nëntor) që do të publikohet, duke përfshirë edhe në faqen e internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (www.pak-ks.org).

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NOTICE OF LIQUIDATION

of
SOE Agricultural Cooperative Liria, Fi-506/92, Skenderaj/Srbica Municipality, Mitrovica/a Region

Alternative/Former names and registration numbers:
OPB "Produkt" OTHK "Qirez" Fi-226/78; KB "Qirez" / ZZ "Qirez" Fi-506/92

Pursuant to Article 9 of Law No. 03/L-067 on The Privatisation Agency of Kosovo, Sections 39.3 and 39.6 of UNMIK Regulation 2001/6 on Business Organisations, and Sections 43.3(d) and (e) and Section 49 of UNMIK Regulation 2005/48 on the Reorganisation and Liquidation of Enterprises and their Assets, **NOTICE IS HEREBY GIVEN** that the Liquidation of the above enterprise was commenced with effect from **04 August 2010** pursuant to a decision of the Board of the Privatisation Agency of Kosovo dated **28 May 2010** under Article 9.1 of Law No. 03/L-067.

In accordance with Sections 43.3 (d) and (e) of UNMIK Regulation 2005/48, any person who believes he/she has a claim against the Enterprise - either as creditor or in respect of any assets related to it or as an owner of the Enterprise or any other claim - should file a **Liquidation Proof of Claim** on or before **16 October 2010**. Failure to do so may result in such persons being unable to participate in any proceeds of sale of liquidation.

Important Notice: With no prejudice to any future claims, the Liquidation Committee advises all concerned that to its best knowledge there are no assets in the inventory of SOE AC Liria, and therefore there will be no funds available for distribution.

The Liquidation Proof of Claim forms can be obtained from, and must be filed with, the following office of the Privatisation Agency of Kosovo:
 Privatisation Agency of Kosovo
 Mitrovica Regional Office
 Address: Mbretëresha Teutë nn, Mitrovica/a (opposite to the Sports Centre)
 Tel: +38128-534-690; Fax: +38128-534 590

The claim forms may also be obtained from the PAK web site at www.pak-ks.org. For details on how to file a claim see "How to register a claim."

A list of assets and a list of claimants will be maintained at the Privatisation Agency of Kosovo, Mitrovica Regional Office, address: Mbretëresha Teutë nn, Mitrovica/a (opposite to the Sports Centre) and will be available for public inspection at this office after 16 October 2010 (or such later date as may publicly be announced) until further notice. If you have legitimate reasons as to why you are unable to travel to the above address, please contact the address to make other access arrangements.

The assets will be offered for sale by sealed bid tender at a date (no earlier than 1 November 2010) to be advertised, including on the Privatisation Agency of Kosovo web site (www.pak-ks.org).

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR MBYLLJEN E PROCESIT DHE PLANIT TË RIORGANIZIMIT PËR KB LIRIA

BLIC

M61BLIC

OGLASI

PONEDELJAK 16. AVGUST 2010.

